



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 756/3 Prot

Tiranë, më 30.09.2021

V E N D I M

Nr.121, datë 30.09.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 134 prot, datë 22.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *** në pozicionin “Administrator i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror” në Njësinë Administrative Ujmisht, të Bashkisë Kukës.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimin e ngritur nga nëpunësi *****.

VËREJ SE:

Në përmbajtjen e një kërkesë, regjistruar me nr. 756 prot, datë 29.07.2021, nëpunësi ***** i emëruar rregullisht, në pozicionin “Shef i Sektorit të Kujdesit Shoqëror, Mbrojtjes Sociale të Fëmijëve Barazia Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut”, në Bashkinë Kukës, parashtron se në datën 22.07.2021, ka marrë në dorëzim vendimin nr. 134 prot datë 22.07.2021 të njësisë përgjegjëse, për transferim të përkohshëm, për një periudhë 6 muajore, në pozicionin “Administrator i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror” në Njësinë Administrative Ujmisht, të Bashkisë Kukës.

Ky vendim sipas tij, është i kundraligjshëm, pasi nuk janë respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil që rregullojnë institutin e transferimit të përkohshëm, për shkak se nuk është ruajtur kategoria e pozicionit siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për

nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi ai kalon nga një pozicion i nivelit të ulët drejtues në një pozicion të nivelit ekzekutiv, gjë e cila shoqërohet edhe me efekte financiare.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së qëndrimit të mbajtur nga institucioni në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimin mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III “*Procedura paraprake*”, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u krye verifikimi i këtij rasti, prej nga rezultoi se:

Punonjësi *****, është nëpunës civil që prej vitit 2015, në administratën e Bashkisë Kukës dhe mban pozicionin “*Shef i Sektorit të Kujdesit Shoqëror, Mbrojtjes Sociale të Fëmijëve Barazia Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut*”, Kategoria III-A/1.

Për nevoja të institucionit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Kukës, me Aktin me nr. 134 prot, datë 22.07.2021, për nevoja të institucionit ka vendosur transferimin e përkohshëm të këtij nëpunësi, për një periudhë 6 mujore, në pozicionin “*Administrator i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror*” në Njësinë Administrative Ujmisht Kukës.

Akti i njësisë përgjegjëse, konstatohet se është nxjerrë në përputhje me kërkesat e nenit 48, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, dhe rregullave të përcaktuara në Vendimin nr. 125 dt. 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësit civil*”. Konkretisht, është mbajtur në konsideratë respektimi i afatit të përcaktuar në pikën 1/a, të nenit 48 të ligjit në fjalë, sipas së cilës, për nevoja të institucionit, nëpunësi civil mund të transferohet deri në 6 muaj, gjatë dy viteve.

Në lidhje me pretendimin tjetër, të mosrespektimit të kushtit ligjor për ruajtjen e kategorisë së pozicionit të punës, në rastet e transferimit të përkohshëm, është sqaruar se ky transferim i përkohshëm, është realizuar brenda të njëjtit sektor dhe nëpunësi, në pozicionin në të cilin është transferuar, do të kryejë punë të të njëjtës natyrë, vetëm se do të ketë një kufizim të juridiksionit tokësor, nga territori i gjithë bashkisë, në territorin e një njësie administrative.

Për më tepër, në zbatim të pikës 5, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, në aktin e transferimit është parashikuar shprehimisht, që për gjithë periudhën 6 mujore të transferimit të përkohshëm, nëpunësi do të marrë pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar. Pra, edhe pretendimi për efekte negative financiare nga ky akt, nuk mund të merret në konsideratë.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se akti nr. 134 prot, datë 22.07.2021, i njësisë përgjegjëse për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *****, nuk përmban elementë të kundërligjshëm, të cilët mund të përbëjnë shkak për të kërkuar anulimin ose shfuqizimin e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bazuar në nenin 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe në mbështetje të nenit 16, pikat 5 dhe 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës paraqitur nga nëpunësi ***** në lidhje me transferimin e përkohshëm të këtij nëpunësi, për një periudhë 6 mujore, në pozicionin “Administrator i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror” në Njësinë Administrative Ujmisht Kukës, pasi nuk u konstatuan veprime administrative në kundërshtim me ligjin dhe arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Kukës dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha